

Nr.regj. 18207/2012

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK/DMP
Nr. i faq Broj stranica	02
Nr Prot. Br Prot Prot No	03-2735/12
Data Datum	03.08.2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehures Dafina Myrtaj nga Prishtina, për kundërvajtje nga nenin 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2, e ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, Nr. 04/L-150, në bazë të nenit 73,74,195,199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79, me datë **30.07.2012** merr këtë:

AKTVE N D I M

E PANDEHURA: Dafina Malë Myrtaj, e lindur më 15.02.1984 në Pejë, tani jeton në Prishtinë, me vednbanim në rrugën "Malush Kosova"pn., u.d.Dejtor i Zyrës për Informim Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me shkollim superior, e martuar, nënë e një fëmije, e gjendjes së mirë ekonomike,

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s e

Sepse, si Zyrtare e Lartë Publike, në pozitë të u.d.Dejtor i Zyrës për Informim Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nuk e ka bërë dekalrimin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2012,

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik**, andaj të pandehures për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej 1500 (Njëmijëepesëqind euro) cilën shumë e pandehura është e obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. Pagesa bëhet në ndonjëri agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor e pandehura është e obliguar të paguaj shumë prej **5 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehures.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate Kërkesën 01-1823/2012 me datë 22.05.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje kundër të pandehures së lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehuren e cila në mbrojtjen e vet deklaroi se e pranon kundërvajtjen e cila i vihet në barrë duke shtuar se nga data 22.02.2012 e deri më 22.03.2012 ka qenë në pushim mjeksor siç edhe e dëshmon me shkresë nga zyra e Sskretarit të përgjithshëm të MPB të datës 23.03.2012, ndërsa edhe pas datës 22.03.2012 kur ishte kthyer në zyrë, nuk e kishte parë fare korrespondencën elektronike të cilën ia kishte dërguar zyrtarja nga personeli, për shkak se vazhdonte të ketë probleme shëndetsore të shtatzanisë dhe nga data 11.04.2012 kishte shkuar në pushim të lindjes. Në vazhdim e njëjta shton se për herë të parë ka qenë në

Nr.regj. 18232/2012

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK / DMP
Nr. l faq Broj stranica Nr. pages	02
Nr Prot. Br. Prot. Prot No.	03-2736/12
Data Datum Date	03.08.2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Ismajl Smakiqi nga Mitrovica, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, Nr.04/L-050, në bazë të nenit 73,74,195,199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79, me datë **01.08.2012** merr këtë:

AKTVE N D I M

I PANDEHURI: Smajl Bajram Smakiqi, i lindur më 21.05.1957 në Mitrovicë, ku edhe tani jeton, me vendbanim në rrugën "Agim Hajrizi" 8/85, Drejtor i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me shkollim superior, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mirë ekonomike,

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, si Zyrtar i Lartë Publik, në pozitë të Drejtor i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2012,

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik**, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej 2000 € (Dymijë Euro) të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. PAGESA bëhet në ndonjërin agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumë prej **5 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate Kërkesën 01-1822/2012 me datë 22.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se e pranon kundërvajtjen e cila i vihet në barrë duke shtuar se detyrën e drejtorit që e mban aktualisht e kishte marrë në muajin tetor të vitit 2011 me ç'rast kishte bërë deklarin pasurisë me marrjen e detyrës, por meqë ky deklarim ishte publikuar në ueb faqe të Agjencisë në vitin 2012, kishte menduar se ai deklarim është i mjaftueshëm për vitin 2012. Në vazhdim thekson se me kohë ka qenë i informuar nga zyrtari i personelit, por ka qenë i bindur se ai veç e ka përmbushur obligimin, më vonë ka kuptuar se ligjërish deklarimi i rregullt vjetor është i veçantë, andaj me vonë, saktësisht me datë 21.05.2012 e kishte deklaruar pasurinë. I